Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/149
Datë: 19.03.2024

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 15.03.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Riakreditohet dhe rivalidohet** Kolegji "ISPE" SH.P.K me adresë: Rr. "Enver Maloku", nr. 49, Prishtinë, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 01.09.2024 deri 31.08.2027, me kualifikimet e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

1.1. **Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë**, Niveli III dhe IV sipas KKK, lloji: Kualifikimet kombëtare të kombinuara (C), me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin mësimor me nga 25 kandidat për një grup në orët e mësimit teorik, ndërsa për orët e mësimit laboratorik 6-8 nxënës për grup. Procesi mësimor mund të zhvillohet në 3 grupe për pjesën e mësimit teorik përgjatë gjithë semestrit.

1.2. **Teknik Dentar,** Niveli III dhe IV i KKK, lloji: Kualifikimet Kombëtare të Kombinuara (C) dhe Kualifikimet Kombëtare Profesionale (D) me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizoj procesin mësimore me 50 nxënës në vit, në dy grupe, duke lejuar një numër maksimal prej 25 nxënësve në klasë.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Kolegji "ISPE" SH.P.K me datë 02.08.2023 ka parashtruar në AKK kërkesë për riakreditim dhe rivalidim të institucionit me kualifikimet: Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë , Niveli III dhe

IV sipas KKK dhe Teknik Dentar Niveli III dhe IV i KKK, e cila është protokolluar dhe ka marrë numër 01/463.

AKK bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ka zhvilluar procedurat për vlerësim të institucionit sa i përket plotësimit të kritereve dhe standardeve të përcaktuara nga AKK.

AKK ka caktuar ekipet vlerësues të eksperteve për vlerësimin e institucionit lidhur më këto kualifikime. Ekipi i ekspertëve vlerësues për kualifikimin Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë, ka shqyrtuar dokumentacionin me datë 13.02.2024, vizitën tek aplikuesi e ka realizuar me datë 15.02.2024 për të bërë vlerësimin e institucionit lidhur me procesin e validimit dhe akreditimit, ndërsa pas analizimit të dosjes dhe realizimit të vizitës tek institucioni, ekipi i eksperteve me datë 26.02.2024 ka përpiluar raportet vlerësuese për riakreditim dhe rivalidim dhe ka dhënë vlerësim pozitiv për institucionin, të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues të AKK-së për vendimmarrje.

AKK ka caktuar ekipin vlerësues të eksperteve për vlerësimin e institucionit lidhur me kualifikimin: Teknik Dentar niveli III dhe IV i KKK, i cili me datë 16.02.2024 ka shqyrtuar dokumentacionin e institucionit aplikues, vizitën tek institucioni e ka realizuar me datë 20.02.2024 për të bërë vlerësimin e institucionit lidhur me procesin e validimit dhe akreditimit, ndërsa pas analizimit të dosjes dhe realizimit të vizitës tek institucioni, ekipi i eksperteve me datë 26.02.2024 ka përpiluar raportet vlerësuese për riakreditim dhe rivalidim për kualifikimin Teknik Dentar, niveli III dhe IV i KKK dhe ka dhënë vlerësim pozitiv për institucionin, të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues të AKK-së për vendimmarrje.

Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për riakreditim dhe rivalidim si institucion ofrues, vlerësues dhe certifikues i kualifikimeve; Raportin e vetëvlerësimit; Vizitën e ekipit të ekspertëve në Kolegjin "ISPE" si dhe dokumente tjera shtesë.

Andaj, në bazë të kërkesës së Kolegjin "ISPE" për riakreditim dhe rivalidim si dhe rekomandimeve përfundimtare të ekipeve të ekspertëve të dhëna në Raportet vlerësuese për riakreditim dhe rivalidim për institucionin aplikues, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:
1. Kolegjit "ISPE" SH.P.K.
2. Arkivit të AKK-së.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK-së